

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
Midis
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHENAVE PERSONALE
dhe
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Këtej e tutje. Palët,

Të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e shtetit të së drejtës për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, dhe të jetës private në veçanti

Të Bindur që ky bashkëpunim i ndërsjelltë do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë;

Me dëshirën E Mirë për të kontribuar në bashkëpunimin nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve

Duke Deklaruar gadishmërinë e tyre në ndërmarrjen e aktiviteteve në kuadër të harmonizimit të legjislacionit dhe të zgjerimit të bashkëpunimit të tyre të ndërsjellte në fusha me interes të përbashket, duke krijuar kështu një kuadër dhe mjedis mbështetës bazuar në barazi, mosdiskriminim, dhe në një barazpeshë të të drejtave dhe detyrimeve;

Duke Riafirmuar vendosmërinë e tyre për të kontribuar në mënyre konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve:

Kanë Vendosur. në ndjekje të këtyre objektivave, të konkludojnë Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1
Qëllimi

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e Ligjit Nr.9918. datë 19.5.008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" si dhe Ligjit Nr.9887, dalë 10.03.2008 "Per mbrojtjen e të dhënave personale' .për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjelltë të dy palëve.

Neni 2

Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

Të dy institucionet konfirmojnë që ndajnë te njëjtin qëndrim për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale të individit. Dy institucionet angazhohen të punojnë mbi parimin e reciprocitetit për të asistuar, bashkëpunuar, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. në komunikimet elektronike

Neni 3

Angazhimet e palëve

Komisionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe autoriteti i komunikimeve Elektronike dhe Postare angazhohen që:

- të bashkëpunojnë për hartimin e rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale në komunikimet elektronike.
- të bashkëpunojnë për hartimin e rregulloreve për sigurinë e të dhënave personale në komunikimet elektronike.
- të bashkëpunojnë duke sigurua të gjithë informacionin që palët kërkojnë për pëmbushjen e detyrave që i ngarkon ligji përkates.
- të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve në rast të shkeljes apo cënimit të privatësisë në komunikimet elektronike, *kjo duke kryer edhe inspektime të përgjithshme të përbashkëta.*
- të bashkëpunojnë në përgatitjen e Kodeve të Etikes.
- të bashkëpunojnë në dhënien e mendimeve të akteve ligjore e nënligjore. që kanë lidhje me të dhënat personale në komunikimet elektronike.
- të marrin pjesë në grupet e punës për hartimin e udhëzimeve të posaçme për mbrojtjen e përdoruesve të rrjeteve sociale në internet në vecanti për moshat e mitura.
- të bashkëpunojnë në grupe pune për të dhënë mendime në hartimin e udhëzimeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në komunikimet elektronike dhe kohën e mbajtjes së tyre,
- të bashkëpunojnë në kuadër projektesh për organizimin e seminareve të përbashkëta në mënyrë që të informohen dhe pajisen me materiale ndërgjegjësuese për ruajtjen e privatisë së tyre.
- të bashkëpunojnë në hartimin e rregulloreve në zbatim të detyrimeve ligjore për përdorimin e komunikimeve elektronike pa kërkesë me pëlqimin e përdoruesit.
- të bashkëpunojnë për shkëmbimin botimeve të ndërsjellta
- të bashkëpunojnë për shkëmbimin e ndërsjelltë të akteve vendimarrëse, rekomandimeve etj

Neni 4

Komunikimi i Palëve

- Palët angazhohen të mbajne një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkënbejnë cdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.
- Palët do të caktojnë një person e kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkpunimit
- Personal e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në cdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër
- Me anë të përfaqësuesve të dyja palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 5

Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të Palëve.

Neni 6

Përfundimi i marrëveshjes

Marrëveshja mund të përfundojë në cdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimi me shkrim nga Pala tjetër.

Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje. Palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 7

Nenshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja e sipërme do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit të saj nga titullarët e palëve.

Nënskmar në Tiranë, më datë 19.04.2011, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Auktoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe dy të tjera në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale

PER AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KRETARI

Z. PIRO XHIXHO

PER KOMISIONERIN PER MBROJTJEN E
TE DHENAVE PERSONALE
KOMISIONERI

Znj. FLORA CABEJ (POGACE)